



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Bajram Mulaku Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Shpëtim Zhegrova Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Lloji i aktit:	Vendim

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 122/17 për formimin e komisionit për arritjen e ujdisë për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit të "UÇK-së.
I miratuar më datë: 27.04.2016
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.05.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bajram Mulaku, gradonačelnik opštine Vučitrn Shpetim Zhegrova, predsedavajući Skupštine opštine Vučitrn
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>for: [Signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i <i>for: [Signature]</i> nadgledanje opština, MALS
	Dana: 08.05.2017. 020-708
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Vučitrn
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.122/17 za formiranje komisije o postizanju dogovora o određenju lokaciju za postavljanje spomenika "UÇK".

Usvojena dana: 27.04.2017. godine

Dostavljen MALS-u za razmatranje dana: 05.05.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



KOMUNA E VUSHTRRISË SHPËTIM ZHEGROVA
01 Nr./Br. 122/17
Nr. i fq./Dr. sh. -1-
Datim / Datum 27.4.2017
VUSHTRRI - VUSHTRIN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" dhe nenin 40.2 "e" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2017, mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ARRITJEN E UJDISË PËR PËRCAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E LAPIDARIT TË UÇK-SË

1. Me këtë vendim formohet komisioni komunal, i cili do të merret me shqyrtimin e propozimeve për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorët e UÇK-së, të Batalionit – I- (parë), të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës, në këtë përbërje:

- 1.1 Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Ali Januzi, anëtar i kuvendit (VV);

2. Komisioni në fjalë ka për obligim që të zhvillojë negociata (bisedime) me përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta dhe me përfaqësuesit e fshatrave se ku do të vendoset ai lapidar.

3. Pas përfundimit të këtij procesi komisioni ka për obligim që të hartojë procesverbal lidhur me arritjen e një marrëveshjeje për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit dhe të njëjtin duhet t'ia adresojë Kuvendit të komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendim obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLAKA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Lokalne Samouprave / Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum 05.05.2017
Date

Niveli i organizimit	Nr. i Lendës	Shpresa	Vlera
-1-	000-108		